

Shprehja e shpirtit lirik të Fishtës në veprën “Mrizi i Zanave”



Letërsi

Fjalë kyçe: Gjergj Fishtës, “Mrizi i Zanave”, tufë, trashëgimia, eposi, gjuha, flamuri, së shekullit XX, satiriku, lirikë, liria, robëria.

Xhevahire Topanica

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ekstrakt

Poema lirike e Gjergj Fishtës “Mrizi i Zanave” është një vepër e tij letrare më e rëndësishme, me të cilën është bërë e njohur letërsia shqiptare. Kjo vepër u botua në vitin 1999 Tiranë. Pra, në këtë vepër varianti himnizues hap kreun me një tufë poezisë ku lavdërohet atdheu fizik, trashëgimia morale e tij, eposi i traditës shqiptare. Autori i këndon i ngazëllyer me një solemnitë të pazakonshëm Shqipërisë, gjuhën shqipe, flamurin shqiptar etj. Temën, të cilën, do ta shtjellojmë në këtë punim analizues dhe studimor është poema lirike “Mrizi i Zanave” të Gjergj Fishtës. Në këtë poemë bëhet fjalë për vjershat atdhetare, ku autori i këndon atdheun në disa variante, si më tematikë të dashurisë, të ankthit, të klithmës, të paçes dhe urrejtës por edhe si një krijues model i shprehjes së përhershmerisë morale të ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës dhe gjuhës shqipe. Siç dihet, poeti, Gjergj Fishta i takon periudhës së shekullit XX, si një krijues i letërsisë moderne shqiptare. Si edhe gjithë poetët e letërsisë moderne, edhe Fishta u bë satiriku më i njohur i letërsisë shqipe, siç e kemi lirikën në fjalë, e cila, shqipton tendosjen shpirtërore që ushqehet nga dashuria, revolta apo dhembja për ta kurorëzuar tematiken e vetë dhe lirinë e robëruar shekullore.

Hyrje

Temën, të cilën, do ta shtjellojmë në këtë punim analizues dhe studimor është poema lirike “Mrizi i Zanave” të Gjergj Fishtës. Në këtë poemë bëhet fjalë për vjershat atdhetare, ku autori i këndon atdheun në disa variante, si më tematikë të dashurisë, të ankthit, të klithmës, të paçes dhe urrejtës por edhe si një krijues model i shprehjes së përhershmerisë morale të ruajtjes dhe zhvillimit të kulturës dhe gjuhës shqipe.

Siç dihet, poeti, Gjergj Fishta i takon periudhës së shekullit XX, si një krijues i letërsisë moderne shqiptare. Si edhe gjithë poetët e letërsisë moderne, edhe Fishta u bë satiriku më i njohur i letërsisë shqipe, siç e kemi lirikën në fjalë, e cila, shqipton tendosjen shpirtërore që ushqehet nga dashuria, revolta apo dhembja për ta kurorëzuar tematiken e vetë dhe lirinë e robëruar shekullore.

Ky poet i madh, si një veprimtar shqiptar, gjatë gjithë jetë punoi për kombin, kulturë, gjuhën dhe vendin në përgjithësi duke jetuar në atë, pra me një ndjenjë të thellë atdhedashurie. Lidhja e përhershme me ambientin e jetës shqiptare, ashtu si dhe përkushtimi shpirtëror i atij françeskan, i vunë tipit, themelet e artit dhe përkushtimit të tij. Ai kishte dashurinë e zjarrtë të “Rilindësit” për vendin, por jo mallin e mërgimtarit që këndon duke himnizuar, prandaj brenda vetes rriste fuqinë vullkanike kundrejt fenomeneve e paraqitjeve të këqija të botës shqiptare. Ai u bë një kritikues i ashpër, i realitetit duke e kthyer artin e vet në tehun qëllimor të satirës, duke prekur fenomene të individit, po dhe të shoqërisë. Prandaj, shprehja e tij dhe poezia janë cilësuar si copë e atdheut .

Gjergj Fishta me veprën e vet krijuese kërkonte dashamirësin e atdhetar të përjetshëm. Në këtë mënyrë lidhi dy periudha të letërsisë shqipe të asaj paramoderne dhe moderne, i cili është urë-lidhëse për dy periudhat në fjalë. Urimi dhe mallkimi që ndjekin njëri-tjetrin në veprat e tij zbulojnë kontrastin e madh të këtyre dy përkatësive krijuese, himnizuese dhe kritike njëherësh.

Poema lirike e Gjergj Fishtës “Mrizi i Zanave” është një vepër e tij letrare më e rëndësishme, me të cilën është bërë e njohur letërsia shqiptare. Kjo vepër u botua në vitin 1999 Tiranë. Pra, në këtë vepër varianti himnizues hap kreun me një tufë poezisë ku lavdërohet atdheu fizik, trashëgimia morale e tij, eposi i traditës shqiptare. Autori i këndon i ngazëllyer me një solemnitë të pazakonshëm Shqipërisë, gjuhën shqipe, flamurin shqiptar etj.

*Edhe hana do t'a dije,
Edhe djelli do t'ket pa,
Se per qark ksaj rrotullije,
Si Shqypnija i vend nuk ka¹⁵⁵*

Ky himnizim i vendit, kalon kohën dhe hapësirën duke u shprehur me figura të amshimit, kurse vendi merr karakterin e përsosjes morale e fizike për t'u përcaktuar me figurën e madhe ballkanike.

Kjo vale e lavdërimit tani kalon në fushën shpirtërore të identitetit të shqiptarëve, të gjuhës shqipe, dhe fuqia e saj mahnitëse, si në vargun:

Porsi kënga e zogut t' verës,

¹⁵⁵ Gjergj Fishta, *Mrizi i Zanave*, Tiranë, 1999, f. 5.

Qi vallzon n blerim të Pyllit
Porsi i ambli fladi i erës
Qi limon gjit e drandafililit
Porsi vala e bregut t detit,

Porsi gjama e rrufes zhgjetare,
Porsi ushtima e njëj termetit,
Njashtu a gjuha e jonë shqyptare.
Gjuha shqipe¹⁵⁶

Siç dihet, autori lidhë figurat e holla lirike me figurat trazuese e dramatike përbrenda zjarrmisë së portretimit të gjuhës shqipe, duke nxjerrë në pah konceptin e vetë për gjuhën shqipe dhe gjuhën e poezisë së vetë. Në këtë portret të brendshëm më shumë duket pikëpamja e Fishtës për veçantitë e veta poetike që njësohen me karakterin e gjuhë amtare. Prandaj, tingëllon fuqishëm mallkimi për ata që nuk e duan e nuk e njohën këtë vlerë.

Po ashtu, himnin e flamurit poeti e nis me figurat e bekimit të famshëm fishtjan.

Porsi fleta e Ejllit t Zotit
Po rreh flamurii Shqypnis,
Bini, Toskë ju bini Gegë
Si dy rrufe, që shkojnë tue djegë
Himni i Flamurit Kombetar¹⁵⁷

Në këtë rast për konceptin e Fishtës, Shqipëri e lirë do të thotë Shqipëri etnike, prandaj edhe në këndimin e tij kalon nga idealitetet në rrafshet reale të shoqërisë. Atëherë kënga e urimit kthehet në këngë të mallkimit, kënga kthehet në vaj. Në qoftë se, urimet e tij shqiptare lidhen me një idealistet e me një përhershmeri, mallkimet lidhen me një realitet e konkretësi jetësore. Pavarësia e Shqipërisë nuk e solli Shqipëri etnike, të cilën frymëzim poeti shqiptari e pranoi si një plagë të pashërueshme. Të këtij disponimi janë këngët e dëshirimit, që me fuqinë e vetë ua këndojnë këngëve të lavdimit dhe dëshirimit si në artin e Fishtës, aty ku shpërthen emocioni, realja doli mbi idealen.

Poezitë “28 Nander 1913”, “Një gjëmë dëshirimit”, “Surgitet, mortui Qohi te dekun” janë lirikat më dramatike atdhetare të këtij autori. Poetika e poetit që thurë përnjëherësh idealet e prishura, ankthi, kushtrimet, thirrjet dëshirimi ndaj të huajve që shprehet si mallkim. Në të tri rastet, hyrjet në vjershat janë mjeshtërore, me ngarkesa emocionale dhe më një përqendrim kuptimor maksimal. Poezia e parë nis me vargun.

Oj zanë t këndojm... t vajtojm, deshta me thanun
Pse sod ditë kanget s asht për mua e tye.
Po ç gzim kjo ditë ne mundet me na dhanë,
Kur, qe, mbas motmoti q iu pëlqye
Evropës shqyptari zot n ship t vet me e lanun
E kujt posë Hyut, m ketë jetë mos me i shërbye,
Shqyptari i dam prap me vedvedin gjinded
E shk asht ma zi prej vedid edhe s bindet...
E ku kjo punë kisht ndodhë posë se n Shqypn¹⁵⁸.

Pra, ky varg ndoshta mund të jetë vargu më tragjik i Fishtës, i ndarë në mes, me tri pika e heshtjes, ku ndahet përgjysmë kënga me vajin për Shqipërinë e ndarë dhe të copëtuar nga Kongresi i Berlinit. Zana, si “artere ego” veta e dytë e poetit është shoqëruesja në këtë tmerr. Vajet dhe mallkimet e përcjellin edhe gjithë vargjet e kësaj strofe. Poezia e dytë nis me vargun.

Mbaroi Malcija, Lekë ma nuk ka
Nuk ka ma burra, qi me drrasë t krahorit
Mburojë me i ndejë Shqypnis, Armiku shkja
Mbas sodit s ka pse dron ma prej malcorit.
Malcori asht thye, e, i dbuem ai me tradhti,
Pa Atme sod ka mbetë pa plag, pa ship¹⁵⁹.

Në vargun e parë të kësaj poezie është një humbje e konceptit të vendit e të trimërisë. Malësi e Lekë, janë figurat themelore të trimërisë e të guximit që ishte ngritur si kult i Shqipërisë në “Lahutën e Malcis”. Me parashenjat e veta sociale Fishta mendon se aty ku liria mbrohet me guxim, e guximi është tretur, humbja merr përmasat tragjike kombëtare.

¹⁵⁶ Po aty, f. 9.

¹⁵⁷ Sabri Hamiti, *Letërsi moderne*, Prishtinë, 2000, f. 23.

¹⁵⁸ Gjergj Fishta, *Mrizi i Zanave*, Tiranë, 1999, f. 29.

¹⁵⁹ Po aty, f.34.

Poezia e tretë nis me vargun
Shqiptarë, a ndjet Europa mrrutë e ndyt...

Fishta këtu i thërret të vdekurit, sepse heronjtë kanë vdekur, apo të gjallët janë të vdekur. Ironia e tij është therëse dhe e dyfishtë. Kjo bëhet më e qartë në vargjet të mëvonshme.

T'u bijë nder, se fort ma e rand asht themra.
E shkjaut kokë trashë, se guri i vorrit m krye.

E gjithë poezia është shkruar me thirrje për humbjet e tokave shqiptare dhe thirrje për zgjim, duke e ngritur në kult fljimin për atdheun, e në këtë vale të kërkesave, vet autori donë të bëhet protagonist i heroikës kombëtare, duke kërkuar të bëhet fli për shqiptari. Ky ton kryengritës i zotëron të gjitha poezitë e dëshpërimit.

Figuracioni elementar i mbështetur në ambientin konkret, me shpresë në trajtën e krahasimit të zgjeruar, është karakteristik për të gjitha këngët atdhetare të Fishtës.

Ky figuracion shprehet me një gjuhë “mashkull” për të liruar energjinë e kundërshtimit deri në rebelim të përgjithshëm. Më rrallë ka abstraksione poetike, sidomos kur një figuracion “qiellor” shënjon përhershëri shqiptare. Këto karakteristika dhe këngën atdhetare të Fishtës e endin nga poli i lavdimit në polin e dëshpërimit, nga niveli i himnizimit e urimit dhe në nivelin e kryengritjes e të mallkimit (për ta bërë këtë një lirikë kryengritëse). Qëllimi i autorit është që rebelimi i tij poetik të bëhet rebelim i përgjithshëm popullor.

Njëra ndër poezitë më të fuqishme personale e Gjergj Fishtës është lirika “Nji lule vjeshte”. Poezia ka karakterin e vetë-rrëfimit dhe sintetizon idetë e lirikave të mëparshme duke i matur me veprimin, me jetën e me vdekjen e njeriut. Në këtë rast figuracioni ambiental krijon lidhjen tokë-qiell dhe e shpie mendimin nga fizika kah metafizika. Kjo poezie provon veprimin jetësor me vdekjen për të arritur pavdekësinë. Kjo procedurë poetike dhe kjo ide është artikuluar me një ndjeshmëri të lartë personale. Në këtë lirikë për herë të parë autori artikulohet si unë, simbol i të folurit poetik dhe i të ndodhurit real.

Një ton i zi elegjik shpalon dhembjen për të dëshirën e vdekur, dhembje që duket edhe në orkestrimin e pamjeve të jashtme të natyrës, ku vendin qendror e zë varri i shprishur. Qenia e dashur e humbur bëhet e amshueshme, kurse poeti ende mbetet genie tokësore, prandaj dialogu ndërmjet tyre është një ndjesi e hollë që lidh dy botët. Ky dialog, në të vërtetë është një monolog i thellë i vetmisë e i dhembjes, që tanimë identifikohet me dhembjen personale të vetë poetit Fishta, i cili bën ushtrimet shpirtërore me shkrim duke kërkuar identitetin të dashuri i humbur.

Poezia kap dramën e shkrimit artistik duke ndërtuar portretin e krijuesit që gjakon përjetësinë si shkallë e fundit të bashkimit me të dashurin, për të krijuar portretin e përbashkët në veprime të mira e të dobishme. Me këtë shkallë Fishta shpall programin e vetë poetik dhe etik, që do t'i realizon në vepra të mëvonshme letrare.

Atë here un kangët kam me i ndertue kreshnike,
Me t cillat botës un do t ia la të shkrueme
Se shka vlejn armët besnike n dorë t Shqyptarit.
E me kangë t mija i përmendar t madhnushme...¹⁶⁰

Krijimi i artit që jetojnë si përmendore e vetvetes është luftë kundër harrimit dhe rezonon Fishta në këtë lirikë të bukur. Ky është një gjakim i madhështisë dhe i përjetësisë. Poezia është një kacafytje ndërmjet jetës kalimtare dhe vdekjes si absolut, duke kërkuar shpëtimin në përjetësinë artistike, të mbetur trashëgimi për pasardhësit.

Poeti i ri, në bisedë të ndjeshme me altarë egon e vet kalon imagjativisht nëpër shkallët e jetës, vdekjes e të përjetësisë. Një projekt i besueshëm për autorin e thellësive të mendimit dhe për njeriun që dashuron të madhërishtmen, çfarë ishte Gjergj Fishta. Fishta në lirikën e tij, të cilën e çmonte si trajtën më të kultivuar të veprës së vet letrare, përdorë vargun tetërrokësh e njëmbëdhjetërrokëshin. Strofet e tij të preferuara janë katrena, më shpesh oktava, strofa, safike e tingëllimin. Në këto kërkime këmbëngulese të formës që shfaqin mjeshtërinë e tij poetike dalin ambiciet e tij krijuese. Mirëpo, fuqia e lirikës së tij mbetet përgjithnjë e veçantë nëpërmjet ndërtimit të figurave, në gjuhën shqipe krejt të veçanta, që mund të quhet dhe karakterizojnë gjuhë e Fishtës. Ajo fuqi vullkanike, që derdhet në vargje, ai rebelim që lirikën e kthen në një kryengritje janë karakteristikat e para të lirikës së tij atdhetare, fetare apo personale, si të “Mrizi i Zanave” si të “Vallja Parrizit” etj. Ashtu, si edhe gjithë poetët e letërsisë moderne që fillojnë nga shekulli i njëzet dhe lidhen me autorët që vijnë pas Naimit, i cili kururizonte letërsinë romantike shqiptare, edhe poeti ynë i madh Gjergj Fishta ishte ndër ata poet, të cilët për gjysmë shekulli ishte figurë zotëruese në letërsinë shqipe. Pra, në veprën lirike të tij “Mrizi i Zanave” shpren dashurin e zjarrtë të Rilindësit për vendin, por jo mallin e mërgimtarit që këndonte duke himnizuar, prandaj brenda vetes rriste fuqinë vullkanike kundrejt fenomeneve e paraqitjeve të këqija të botës shqiptare.

¹⁶⁰ Gjergj Fishta, **Mrizi i Zanave**, Tiranë, 1999, f. 217.

Pra, siç e pamë edhe në gjithë vështrimin e këtij punimi analizues dhe studimor se poeti i ka kënduar atdheut në disa variante, si dashuri, si anktë e klithmë dhe si përhershmeri morale, dhe së fundi këto i përmbledh në një lirik personale dhe vlerë të thellë kombëtare. Varianti himnizues hap kreun e librit me një tufë poezish ku lavdërohet atdheu fizik, trashëgimia morale e tij, eposi i traditës shqiptare (...).

Literatura

1. Çaushti, Tefik; Shkurtaç, Gjovalin, **Kadareja dhe fjala shqipe**, Tiranë, 2004.
2. Çiraku, Ymer, **Shqyrtime kritike nga historia e letërsisë shqipe**, Tiranë, 2011.
3. Domi, Ornella, **Kadare në psikoanalizë**, Tetovë, 2009.
4. Eco, Umberto, **Si bëhet një punim diplome**, Tiranë, 1997.
5. Fishta, Gjergj; **Mrizi i Zanave**, Tiranë, 1999.
6. Hamiti, Sabri; **Letërsi moderne**, Prishtinë, 2000.
7. Isufaj, Viola, **Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë**, Tiranë, 2013.
8. Kadare, Ismail, **Baladë për vdekjen J. G. Vëllimi IX**, Tiranë, 2008.
9. Kadare, Ismail, **Bisedë për brilantet në paditen e dhjetorit**, Tiranë, 2013.
10. Kadare, Ismail, **Fatkeqësia nga Suzana**, Vëllimi II, Tiranë, 2007
11. Kadare, Ismail, **Gjenerali i ushtrisë së vdekur**, Tiranë, 1962.
12. Kadare, Ismail, **I vetmuari**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
13. Kadare, Ismail, **Kënga**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
14. Kadare, Ismail, **Leximi i Hamletit**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
15. Kadare, Ismail, **Nata e sfinxsisë**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
16. Kadare, Ismail, **Në periferi pranë aeroportit**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
17. Kadare, Ismail, **Nudo**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
18. Kadare, Ismail, **Perandori**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
19. Kadare, Ismail, **Prilli i thyer**, Tiranë, 1980.
20. Kadare, Ismail, **Prometeu**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
21. Kadare, Ismail, **Prometheu**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
22. Kadare, Ismail, **Provokacioni**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
23. Kadare, Ismail, **Që të mbetet diçka nga Ana**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
24. Kadare, Ismail, **Raporti i fshehtë**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
25. Kadare, Ismail, **Sjellësi i fatkeqësisë**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
26. Kadare, Ismail, **Stina dimërore e kafe "Rivierës"**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
27. Kadare, Ismail, **Treni dimëror i linjës së largët**, Vëllimi II, Tiranë, 2007.
28. Kadare, Ismail, **Vjedhja e gjumit mbretëror**, Vëllimi IX, Tiranë, 2008.
29. Qosja, Rexhep, **Tri mënyrat të shkrimit shqip**, Prishtinë, 2004.
30. Shala, Kujtim, **Acta Albanica (Qarku letrar i Prishtinës)**, Prishtinë, 2009.
31. Shala, Kujtim, **Prolepsi**, Prishtinë, 2011.
32. Shala, Kujtim, **Shekulli i romanit shqiptar**, SNGJLKSH, Prishtinë, 2009.
33. Shala, Kujtim, **Vox-i i Anton Pashkut**, Prishtinë, 2002.
34. Shema, Isak, **Versionet e poezisë së Ismail Kadaresë**, SNGJLKSH, Prishtinë, 2010.
35. Sinani, Shaban, **Një dosje për Kadarenë**, Tiranë, 2005.
36. Vinca, Agim, **Arti i reagimit**, Prishtinë, 2011.
37. Vinca, Agim, **Orët e poezisë**, Prishtinë, 2010.
38. Vinca, Agim, **Poetika e fjalë**, Tetovë, 2010.